

**Oral History** Kosovo

---

**Oral History** Kosovo

---

## INTERVISTË ME DRAGUTIN IVANOVIQIN

Janjevë | Data: 3 korrik, 2019

Kohëzgjatja: 110 minuta

Të pranishëm:

1. Dragutin Ivanoviq (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

### Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Çka ju kujtohet nga fëmijëria?

**Dragutin Ivanoviq:** Nga fëmijëria ka shumë momente që i kujtoj me lumturi. Ka momente shumë të bukura por ka edhe pak më të vështira... Më kujtohet, do të ju them, ne në familje kemi qenë tetë. Kjo është karakteristike për Janjevën, por edhe në tërë Kosovën, apo jo?! Familja mesatare në Janjevë ka

mundur të jetë diku në një periudhë të caktuar edhe dhjetë anëtarsh. Tek në kanë qenë tetë, pesë vëllezër, vëllezërit dhe tri motra. Unë jam njëri prej më të vegjëlve, vëllezërve më të vegjël. Përndryshe pas meje janë edhe tri motra. E tani çfarë më kujtohet... nuk janë kujtime aq të bukura sepse ashtu kanë qenë kohërat. I lindur '50-tën shikoni dhe tani 'ajt nëse kujtoj nga mosha shtatë-tetë vjeçare, do të thotë është diku '56-ta, '57-ta dhe kështu...

Më kujtohet ajo kohë, fillimi i shkollës, nisja në klasë të parë që është interesante. Për çdo fëmijë ka qenë prandaj edhe për mua, por nuk ka pasur kushte si tani. Më kujtohet, kemi shkuar në shkollë e cila ka qenë në kuadër të kishës, kishës katolike, sepse këtu kryesisht, ju me siguri e dini, kryesisht ka qenë popullsia kroate deri diku në vitet '90, '91, '92. Më kujtohet ajo shkollë ka qenë e rrënuar, ka qenë e errët. Ne kemi qenë plot fëmijë e disa banka të drurit, të cilat tani nuk mund t'i përshkruaj mjaftueshëm mirë me fjalë. Duhet t'i shohësh, kanë qenë shumë jo funksionale. Por, megjithatë për neve kanë qenë të mira. Ne aty i morëm mësimet e para, takimi i parë me mësuesen, mësuesin dhe shoqërimi. Dhe veçanërisht çfarë më ka mbetur në mendje, kemi qenë shumë në paralele, në klasë.

Dhe ka qenë, ka qenë simpatike për neve. Mezi kemi pritur që të vij dita tjetër që të shkojmë prapë në shkollë. Dua të them që kemi shkuar me gëzim. Ja këto janë ashtu momentet e para që normalisht më kujtohen mua dhe secilit, sepse njeriu, të kujtohen ditët e para të shkollës dhe kështu...

**Anita Susuri:** E si ka qenë jeta në familje?

**Dragutin Ivanoviq:** Në familje jeta ka qenë e ngjashme edhe, edhe me atë në shkollë, ka qenë jo funksionale, ka qenë e vështirë. Kultura e jetesës ka qenë në nivel shumë të ulët, kushtet në të cilat është jetuar kanë qenë shumë të rënda. Familjet shumë-antarëshe apo jo, familja e madhe, dhe familjet e mëdha, mungesa e kushteve sjell gjithë atë që e përcjell, sepse një jetë normale e njeriut, atë nuk e kemi pasur. Kështu që, më kujtohen ato shtëpitë e vjetra, fryn era gjatë dimrit nuk mund të ngrohemi mjaft. Tetë prej neve edhe babai edhe nëna, dhjetë, do të thotë gjithsej, 'ajt ndoshta në 50 metër katror. Kështu që, kjo më kujtohet, jo me aq lumturi por e mbaj mend.

**Anita Susuri:** Na keni folur për shtëpinë e vjetër...

**Dragutin Ivanoviq:** Shtëpia e vjetër, kushtet shumë të rënda, më kujtohet deri në vitin '62 nuk ka pasur as rrymë. Më kujtohet si djalosh i vogël i kam pasur dymbëdhjetë vjet kur e kemi marrë rrymën dhe kur e kemi parë si duket gjithë ajo, unë kam menduar që jam në një botë tjetër, nuk kam mundur ta kuptoj, kemi jetuar me njëfarë llampe me vajguri, njëfarë gazi vajguri, disa llamba karabine të cilat janë përdorur në miniera. Kështu që, kjo më kujtohet do të thotë, kushtet shumë të rënda, por me ardhjen e rrymës sado pak ndjehet një përmirësim, apo jo? E kemi lutur atëherë babain që sido që mundet, të na e blej një radio, të paktën ta kemi në shtëpi. Kështu që, kur e kemi fituar atë radion, atëherë gjithçka, si shkonin vitet, gjithçka ka shkuar disi më me lehtësi dhe më lehtë me ato, me ato kushte të jetesës dhe kështu... ja kjo, kjo më kujtohet si djalosh dymbëdhjetë vjeçar.

Atëherë nuk ka pasur as mjaftueshëm elektrikista, mjeshtër që do t'ua instalonin atë [rrymën], sepse Janjeva atëherë ka qenë mjaft e madhe, në kuptimin që ishim shumë njerëz dhe të gjithë dëshironin ta

instaloni atë sa më shpejt, e nuk ka pasur mjaftueshëm mjeshtër, elektrikista. Dhe pastaj më kujtohet njëfarë Kosta, i cili ka ardhur diku nga thellësia e Serbisë me siguri, dhe pastaj, i them babait, “Po ‘ajt lute atë xhaxhi Kostën që të vij nesër që edhe neve të na ndriçoj”. Dhe kështu...

**Anita Susuri:** Me çka është marr babai juaj, dhe nëna?

**Dragutin Ivanoviq:** Nëna ka qenë amvise, e babai ka punuar në kooperativën bujqësore në Janjevë, ka qenë njëfarë kontabilisti, llogaritar dhe kështu.

**Anita Susuri:** A ka qenë njeri i shkolluar apo?

**Dragutin Ivanoviq:** I shkolluar jo, kjo ka qenë më shumë nga praktika, por më vonë me zhvillimin e asaj kooperative e ka përfunduar më vonë edhe [shkollën] e mesme ekonomike dhe kështu. Kështu që, i ka plotësuar disa kushte në mënyrë që të mund të punonte normalisht.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet si është dukur Janjeva kur keni qenë ju i vogël?

**Dragutin Ivanoviq:** E më kujtohet shumë, shumë mirë. Dhe do të ju them, në fakt do t’ju tregoj disa detaje të cilat ashtu, më kanë mbetur në kujtim, të cilat i kujtoj edhe sot. Më kujtohen rrugët me baltë para së gjithash, familjet shumë antarshe, kushtet e rënda për jetë. Më kujtohet Janjeva gjatë verës pluhur i madh, nëse bie shi shumë baltë, e megjithatë nënat tona bënë çmos që ta mbajnë atë pastërtinë aq sa ishte e mundur, në mënyrë që të shkonim në shkollë si fëmijë të denjë, apo jo. Do të thotë, rrugët kanë qenë shumë të baltosura dhe nuk mundej pa çizme. Çizmet kanë qenë një rekvizitë bazike kur janë këmbët në pyetje, pa çizme nuk mundej.

Shkuarja në shkollë, të ju them, ishte shumë e vështirë. Në shkollë njejtë kushtet mjaft, mjaft të rënda i kishim sepse ka qenë periudhë e pasluftës, e kam fjalën për Luftën e Dytë Botërore sepse kanë kaluar gjithsej 15, 10, 15 vite. Nuk ka pasur ujë në shkollë, nuk kanë qenë nevojat elementare për një zhvillim normal të mësimi... Familjet shumë-anëtarshë, nuk ka për mëngjes, nëna atëherë, më kujtohet na përgadiste disa vezë e vendoste më shumë kripë se sa duhej, në mënyrë që ta zmadhonte atë shujtë dhe pastaj kjo shkaktonte etjen. E shkoja në shkollë dhe nuk kishte ujë për të pirë. Më kujtohet arsimtarja apo arsimtari i gjeografisë, na flet ai neve për Savën dhe Danubin, si është Danubi i pastër dhe i kthjellët e unë i etur, unë tani do të...

**Anita Susuri:** (qesh)

**Dragutin Ivanoviq:** Unë tani do të hyja në atë Danub, në atë Savën, unë i etur për një pikë ujë. Dhe pastaj menxi pres që ora, ora mësimore të përfundoj. Në shkollë nuk ka ujë, e shkojmë, tek fqinjët kishte bunarë të mirë. Ju e dini çka është bunari?

**Anita Susuri:** Po.

**Dragutin Ivanoviq:** Kishte bunarë të mirë, dhe pastaj kur e shohim ujin, mendoj se jam njeriu më i lumtur në botë. Ja kjo, kjo më ka mbetur në mendje, ajo orë e përshkrimit të tokës apo gjeografisë, sido që doni, Danubi dhe Sava si rrjedhin të pastër e unë i etur. Dhe më kujtohet që është dashur të punojmë në shkollë përkatësisht të mësojmë në tri ndërrime. Kështu që ndërimi i tretë i nxënësve ka qenë nëpër terr, sidomos ka qenë e papërshtatshme në ditët e shkurtëra të dimrit dhe të vjeshtës. Errësira bie shumë herët e ne duhej të shkonim në shkollë, ndonjëherë ka pasur edhe stuhi, por për Zotin jemi frikësuar edhe nga qentë e fshatit dhe kështu me radhë. Ja kjo më ka mbetur, ka pasur shumë fëmijë ato vitet kur unë kam qenë në klasë të shtatë-tetë, kanë qenë rreth njëmijë e dyqind nxënës apo njëmijë e dyqind, sido që dëshironi, nxënës, e kushtet shumë të rënda.

**Anita Susuri:** A është i njeiti objekt që është tani te kisha apo është renovuar?

**Dragutin Ivanoviq:** Eh, do t'ju tregoj, me rritjen e numrit të nxënësve, shumë herët e kemi braktisur objektin në kishë. Aty kam qenë në të parën, të dytën [klasë] 'ajt në vitin '56 dhe '57. Pastaj është bërë shkolla në këtë lokacion ku edhe është tani. Nuk e di saktë në cilin vit, por e di që herët e kemi braktisur objektin në kishë, kemi kaluar në këtë shkollë ku sidoqoftë, sidoqoftë ka qenë diçka më e lehtë sepse megjithatë ajo ishte e re. Edhe pse nuk është ajo në, në formën e sotme etj. Por ka qenë më lehtë edhe me zhvillimin e shkollës edhe me rritjen e numrit të nxënësve, pastaj është bërë edhe një objekt, që do të thoshim edhe një krah i shkollës kështu që e kemi tejkaluar, eliminuar atë ndërrimin e tretë për të cilin po flisja pak më parë.

**Anita Susuri:** Do të thotë, katër vite i keni kaluar në atë shkollën e vjetër?

**Dragutin Ivanoviq:** Në atë shkollën e vjetër, pikërisht ashtu dhe pastaj ndoshta pas katër - pesë viteve. Pas luftës më kujtohet mua mirë si djalosh ndërtimi i asaj shkollës së re, neve na vinte mirë kemi luajtur... pak i kemi penguar ata njerëzit të cilët është dashur ta përfundojnë këtë [shkollë] sa më shpejtë dhe të punojnë, por na ka ardhur edhe më mirë sepse vet lokacioni ka qenë më i gjerë dhe kemi mundur të luajmë më mirë si fëmijë, dhe kështu...

**Anita Susuri:** A ju kujtohet infrastruktura e Janjevës? Si kanë qenë shtëpitë?

**Dragutin Ivanoviq:** Si jo, infrastruktura në Janjevë në atë kohë për të cilën po flasim e ka pasur një stil të ndërtimit të shtëpive, ky ka qenë stili i ndërtimit turk, ndërtimi i tipit lindor të shtëpive. Shtëpitë kanë qenë të ndërtuara nga materialet shumë të thjeshta. Kur them prej materialeve të thjeshta më shumë ka qenë prezent guri në atë pjesën e poshtme ku është themeli i shtëpisë. E pjesa tjetër është bërë, ku ta di prej ndonjë druri, kombinim i drurit dhe baltës. Pastaj artifi... pastaj qerpiç ajo është e baltës, tullë prej balte. Kur ka ardhur ajo atëherë ka qenë më lehtë të ndërtohet shtëpia. Por përgjithësisht kanë qenë jo funksionale.

Në një hapësirë ka qenë vatra, e dini çfarë është vatra? Përafërsisht aty ke gatuar, aty ke ndenjur, aty je shoqëruar. Dhe aty përafërsisht ka qenë si thuhet sot dhoma e ditës apo ndonjë sallon dhe kështu me radhë. Do të thotë, shtëpitë kanë qenë të stilit të Lindjes e vet konfiguracioni i vendit ka qenë i tillë që rrugët kanë qenë të ngushta. Aty është pak, e shihni edhe sot është një konfiguracion i tillë, nuk ka

mjaft hapsirë. Kështu që, mungesa e asaj hapsire edhe e ka determinuar çfarë do të jenë edhe shtëpitë. Do të thotë, në përgjithësi shumë të dendura, të ngushta dhe jo funksionale.

**Anita Susuri:** Pastaj kur e keni përfunduar shkollën fillore, çka u bë pastaj?

**Dragutin Ivanoviq:** E pastaj e dini vijnë ato, ato më të rënda, më të rënda ashtu të them, vuajtjet e njeriut. Pastaj e kam ndjekur shkollën teknike, këtu në afërsi nuk ka pasur kështu që është dashur klasën e parë ta regjistroj në Ferizaj, Ferizaj. Më kujtohen ditët e para shkollore, sidomos më kujtohet konvikti, nuk e di a e dini ju, është shtëpi për nxënësit. Dhe në atë konviktin në Ferizaj kemi qenë nga të gjitha shkollat, edhe e mesimdhënjes, edhe gjimnazi edhe ekonomia... Ka qenë shumë bukur dhe simpatike, edhe pse kushtet nuk kanë qenë normale, unë shpesh te kjo bisedë po kthehem te kushtet e asaj kohe. As në atë konvikt nuk ka pasur kushedi se çfarë standarde, por ka qenë shumë bukur dhe simpatike. Së pari kemi qenë të rinj, por veçanërisht na ka mbetur në mendje shoqërimi i bukur.

Aty ka qenë me të vërtetë konvikti i nxënësve shumëkombësh. Ka pasur shqiptarë, ka pasur kroatë, ka pasur serbë, ka pasur romë, të gjithë kemi qenë në atë konviktin, dhe mund t'ju them që shumë mirë ka qenë. Kjo më ka mbetur në kujtim, vitet e para sepse vitet e tjera pastaj kam kaluar, kemi kaluar një grup që kemi qenë nga Janjeva këtu. Përndryshe, na ka dhënë bursë fabrika "Metaliku", pastaj vitet tjera kemi kaluar në Prishtinë, ku e kemi pasur më lehtë, më afër. Pastaj kemi pasur kushte më të mira në Prishtinë, më kujtohet, 'ajt '67-tën apo '68-tën është ndërtuar një konvikt i ri, apo internat si është quajtur, ku kemi qenë vetëm tre në dhomë, shumë-funksionale, bukur. Atëherë kemi mundur më shumë t'i përkushtohemi mësimi dhe kështu.

**Anita Susuri:** Kur e keni filluar shkollën e mesme, a ka qenë kjo hera e parë që keni shkuar jashtë Janjevës?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, nuk ka qenë hera e parë. Sepse edhe para kësaj, babai më mori disa herë në Zagreb, sepse vëllau më i madh atëherë tashmë jetonte në Zagreb. Atje shërbeu në APJ<sup>1</sup> ushtrinë, dhe pas ushtrisë menjëherë mbeti në një fabrikë në Zagreb, kështu që nuk është hera e parë. Shpeshherë si djalosh, prindi, babai më merrte në Zagreb, kështu që kjo nuk ishte hera e parë që jam larguar nga Janjeva.

**Anita Susuri:** Si e keni përjetuar atë udhëtimin, si ju është dukur?

**Dragutin Ivanoviq:** Paj shikoni, si çdo njeriu të ri, si çdo djalosh që niset nga një mjedis shumë i largët në gjerësi, në hapësirë, në një mjedis tjetër, për herë të parë e gjithë kjo ishte shumë interesante për mua, por me një dozë të vogël të frikës, çfarë, kur do të mbërrijmë. Atëherë normalisht për herë të parë e kam parë trenin, trenin, apo jo, dhe deri atëherë e kam parë vetëm në foto si duket dhe tani vetëm ajo hyrje, ajo hapësirë në tren, e gjithë kjo ka qenë simpatike për mua. Pastaj figurat nëpër të cilat kalonim, natyra dhe pejsazhi kanë qenë shumë të dashura sepse përveç këtyre kodrave, deri atëherë asgjë nuk kam parë, kështu që e gjithë kjo ka qenë shumë interesante dhe ajo rrugë më ka

---

<sup>1</sup> Armata Popullore Jugosllave

kaluar shumë shpejtë. Ndryshe nga babai, i cili, vitet e kanë bërë të veten apo jo, mërzitet, e kur do të mbërrim, e ndonjë ndalesë, e gjithë kjo nuk ka qenë e tipit modern sikur tani apo jo, por ai udhëtim ka qenë shumë interesant për mua, sidomos natyra dhe gjithë ajo që më rrethonte dhe kështu.

**Anita Susuri:** Do të thotë pas shkollës së mesme, keni thënë që pas një kohe keni shkuar në Prishtinë. Si ka qenë?

**Dragutin Ivanoviq:** Në Prishtinë ka qenë, ju thashë, e kam pasur, e kam pasur më të lehtë të udhëtoj, më afër e kemi... Edhe pse nuk kanë funksionuar mirë sikur tani linjat e autobusit dhe pjesa tjetër e transportit. Sidoqoftë, ka qenë më e lehtë, kam mundur në mëngjes të shkoj në mësim dhe pasdite të kthehem në shtëpi. Por as ajo nuk ka qenë aq e thjeshtë sepse gjithsej njëherë në ditë shkonte busi. Duhej, e shfrytëzoja pastaj Prishtinë-Kishnicë e shpeshherë ka pasur brenda ditës, por prej Kishnicës pastaj në këmbë mbi këto kodra duhej një orë. Ja kjo është afërsisht ka qenë diçka më e lehtë, por kur e kemi fituar vendin në konviktin e nxënësve në Prishtinë, atëherë e gjithë ajo u përmbledh në gjithsej një herë, një herë në javë.

Do të thotë, të dielën vinim në shtëpi dhe merrnim me vete në ndonjë çantë pak më shumë rroba të papastërta, atëherë nëna i lante ato dhe të hanën ktheheshim. Sidoqoftë, ka qenë pak më lehtë. Prishtina ka qenë interesante në krahasim, nëse do të, është e pakrahasueshme tani dhe atëherë, por jeta ka qenë mjaft simpatike, dinamike. Ka qenë një rrugë, një restorant, më kujtohet kinemaja “Vllaznimi”, shkonim si djelmosha, nganjëherë edhe i lëshonim orët nëse është filmi i mirë, apo jo? Kështu që, Prishtina ka qenë shumë, shumë interesante, një vend shumë interesant qytetëz tipike e Lindjes. Por tani nga ky kënd dhe nga kjo perspektivë, dhe me këtë mënyrë të mendimit mendoj se shumë pak është investuar në atë qytet.

Kjo është një pikëpamje e imja dhe nuk do të doja tani të politizoja asgjë rreth kësaj. Më shumë dua të them që Prishtina e ka pasur atëherë kinema “Vllazninin”, që ka qenë interesante për neve, njëfarë restoranti “Ekspres”, a është quajtur “Avalla” apo “Beogradi”, nuk po më kujtohet, kjo më kujtohet.

**Anita Susuri:** Ku tjetër për shembull keni shkuar nëpër Prishtinë, a keni dalur?

**Dragutin Ivanoviq:** Paj dalje të organizuara nuk ka pasur. Shkonim tek, tek njëri - tjetri, te disa shokë, dhe në shkollën teknike kemi qenë edhe djem edhe vajza aty nga Prishtina. Kështu që, ndonjëherë na thërrisnin të shkonim edhe në shtëpi te ata, në shtëpi, kështu që dalje të organizuara nuk kishte. E gjithë ajo ka qenë individuale por më shumë në qytet aty dhe rrethin më të afërt. Më kujtohet Gërma dhe kur bëhej verës kjo nxehtësia e padurueshme, atëherë hajde pak deri në Gërmi dhe kështu.

**Anita Susuri:** A keni, sa keni udhëtuar ashtu nga Prishtina në Janjevë?

**Dragutin Ivanoviq:** Të gjithë, të gjithë shkollën e mesme deri sa e kam përfunduar. Do të thotë, diku tri-katër vjet, sepse njëra ka mbetur në Ferizaj e këto janë do të thotë tre vite, kështu ka qenë gjithnjë.

**Anita Susuri:** Çdo ditë keni udhëtuar ashtu?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, ju kam thënë, që disa muaj ndoshta kemi udhëtuar çdo ditë, pastaj është ndërtuar ky konvikti i nxënësve për të cilin po flisnim. Atëherë internati i ri ka qenë i përfunduar dhe ne aty e kemi fituar vendin, kështu që një herë, një herë në javë, një herë kemi udhëtuar. Do të thotë, një herë në javë kemi ardhur, kështu që çdo ditë ka qenë me ndërtimin dhe përfundimin e konviktit, një ditë do të thotë ka shkuar në histori, në të kaluarën...

**Anita Susuri:** E kur keni qenë ju të rinj a keni, a ju kujtohet Janjeva, jeta në Janjevë?

**Dragutin Ivanoviq:** Si nuk më kujtohet?! Jeta në Janjevë në ato vite ka qenë mjaft dinamike. Në një vend kështu të vogël, hapësirë të vogël, të vendosur, përkatësisht kanë jetuar shumë njerëz. Në ato vite, mua më kujtohen disa regjistra 'ajt të vitit '70, '71, kanë jetuar rreth katër mijë njerëz. Dhe ka qenë shumë interesante që numri aq i madh i njerëzve të jetë në një hapësirë aq të vogël dhe më kujtohet që ka qenë shumë romantike. Shumë simpatike ka qenë të jetosh në secilën prej këtyre rrugëve, sokaqeve, mund të dëgjohej kënga, serenada, kitaret, secili e ka pasur shoqërinë e vet dhe ne kemi kënduar nëpër rrugë. Askush nuk na ngacmonte, asnjërin ne nuk e kemi ngacmuar, ato kanë qenë këngët, serenadat e qeta të lehta.

Pak mundësi për një argëtim më dinamik, kështu që vetëvetes ia kemi krijuar disa kushte që jetën ta kemi më interesante. Më kujtohet atëherë fundi i '60-tave, ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe e kemi fituar sallën e kinemasë dhe pastaj kjo ka qenë për, kjo ka qenë ideja që ne mund ta shikojmë Din Martinin apo jo dhe disa filma me kauboj dhe kështu. Pastaj e kemi pasur më të lehtë dhe më simpatike. Çdo të diel mblihdheshim në atë Shtëpi. Kanë qenë ato ballot kombëtare, vallzimet, muzika e gjallë. Normalisht të cilën e kemi bërë vet, e kemi finansuar dhe kështu me radhë.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet diçka, diçka që ju ka ndodhur juve aty në atë kinema apo kur keni qenë në ato organizimet?

**Dragutin Ivanoviq:** Në një, nuk e di në çfarë kuptimi po mendoni kur më pyetni a ju kujtohet, nuk e di a në kuptimin negativ apo pozitiv...

**Anita Susuri:** Jo, në atë pozitiv, për shembull, a keni shkuar me shoqëri apo çfarë keni shikuar atje...

**Dragutin Ivanoviq:** Gjëra pozitive ka pasur shumë. Nëse do më pyesnit për ato negative, nuk do të më kujtohet, shumë pak kanë qenë në jetë, edhe pse ka pasur ato, ato lindën si pasojë e çapkënërisë djaloshare të një të riu. Por pozitive shumë... më kujtohet rasti kur nuk kishim para për të blerë më shumë kitara, më shumë daulle, më shumë instrumente që do të na lehtësonin dhe përmirësonin kualitetin e atyre ballove. Dhe pastaj nëse mund të shprehem ashtu, i mërzisnim ata njerëzit në komunë na jepni investoni pak në rini, "Jepni investoni, na nevojiten më shumë para, për atë për këtë". Kështu që, më kujtohet sa herë që kishim momente të tilla e na jepnin pak para dhe pastaj ne mblihdhnim dhe më kujtohet se atëherë e kemi formuar orkestrën tamburine. Dhe kjo ka qenë, kjo ka qenë për, në atë kohë me të vërtetë bazike, jo vetëm për Janjevën por për të gjithë këta fshatrat këtu dhe kështu me radhë.



**Anita Susuri:** A keni luajtur edhe ju ndonjë instrument?

**Dragutin Ivanoviq:** Po, kam luajtur kitarë dhe bas kitarë, deri sa në një moment e kam thyer këtë dorën dhe nuk mund ta, kështu që po, si jo. Kam qenë shumë aktiv në të gjitha këto, prej blerjes përmes [të hollave që fitonim] luajtjes, organizimit dhe kështu me radhë.

**Anita Susuri:** A keni luajtur muzikë të huaj apo vetëm...

**Dragutin Ivanoviq:** Më shumë është luajtur romanca e lehtë vendore, këngët e vjetra qytetare të bukura. E për besë i pranishëm ka qenë edhe Tom Xhons [Tom Jones], kanë qenë të pranishëm edhe Bitëllsat [Beatles] kështu që kemi luajtur edhe njërin edhe tjetrën. Fatkeqësisht shumë pak kemi... ose nuk i kemi ditur apo ku ta di unë... Kënge popullore kemi pasur shumë pak, më shumë jemi orientuar në atë muzikën e cila ka qenë më moderne në atë kohë. Janë ato, për shembull Misha Kovaç apo ku ta di unë Jevremoviqi. Madje edhe disa këngë tona të vjetra prizrenase, dhe kështu me radhë.

**Anita Susuri:** (kollitet) A ju kujtohen disa objekte të vjetra këtu në Janjevë, për shembull, çarshia, xhamia, kisha?

**Dragutin Ivanoviq:** Shumë, shumë me kënaqësi nganjëherë kthehem, me trishtim dhe melankoli për ato objektet që nuk janë më në atë formë. Më kujtohet si jo, më keni pyetur pikërisht për xhaminë. Ja e cila është aty afër, afër neve. Më kujtohet si fëmijë ajo xhamia e vjetër ku kemi ditur të shkojmë të luajmë me rruaza dhe kështu me radhë. Ajo ka qenë disi në formën e sotme e ruajtur, shpejt e kanë renovuar. Më kujtohet edhe kisha, normalisht, unë duhet të ju them edhe pse nuk më keni pyetur, kisha ka qenë shumë me ndikim për zhvillimin e të rinjve.

Kisha ka pasur shumë ndikim në zhvillimin e të rinjve. Kisha është, kur them ka pasur shumë ndikim, vlen për çdo aspekt. Normalisht para së gjithash në atë shpirtëror por atje kemi ditur të... Pingpongu i parë që ka arritur në këtë hapësirë më të gjerë, duke përjashtuar normalisht Prishtinën, ne e kemi pasur në kishë. Ne aty jemi mbledhur, kemi vallëzuar, kënduar, e shfrytëzonim atë pingpongun. Ndryshe nga shkolla, në kishë ka pasur shumë instrumente. Më kujtohet organoja, që ka qenë njëra nga më modernet në atë kohë edhe tash. Atje i kemi mësuar të parat, notat e para. Atje kemi fituar krahas asaj që ju tregova në aspektin shpirtëror, ne gjithashtu fituam një kulturë të caktuar perëndimore, nëse mund të shprehem kështu. Sepse aty priftërinjtë katolikë, më shumë kanë qenë sllovenë dhe ata normalisht me vete kanë sjellë disa zakone të tyre dhe pjesë të kulturës të cilën na e kanë mbjellur neve.

Kështu që më kujtohet kisha si institucion, deri tani ju fola, e më kujtohet që ka qenë edhe shumë e vjetër. Shkojmë në kishë për meshë e tani për ato ceremonitë duhet të gjuhëzohesh, duhet t'i përlyesh pantollonat. Dhe pastaj më kujtohet nëna më jepte pak letër ose prej ndonjë fletore ose prej ndonjë gazete thotë, "T'i vendosësh," thotë, "pantollonat nuk mund t'i laj gjithnjë, nuk kemi mjaft ujë". Ka qenë do të thotë normalisht në një gjendje më të rëndë se që është sot, dhe kjo më kujtohet. Pastaj më kujtohet zyrja e famullisë, ajo është shtëpia ku kanë jetuar dhe banuar priftërinjtë dhe

motrat e nderit. Ajo ka qenë një shtëpi e vjetër, një stil tipik i Lindjes me ato shkallët e brendshme të drurit të cilat janë lëkundur dhe këmbët kanë mundur të... Më kujtohet do të thotë edhe kjo, ka qenë, ka qenë shumë e vështirë edhe për ata priftërinjtë në kushte të tilla por si ka qenë populli, ashtu edhe ata dhe ndryshe nuk ka mundur, apo jo...

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Pas shkollës së mesme në Prishtinë, çfarë ka ndodhur pastaj, a keni...

**Dragutin Ivanoviq:** (psherëtimë) Pas shkollës së mesme në Prishtinë punësohem dhe punoj në fabrikën “Metaliku”, të cilët më kanë dhënë bursë, në atë kohë ashtu ka qenë, kush më ka dhënë bursë aty kam filluar punën. Atëherë e ka pasur më të lehtë edhe nëna edhe babai, edhe një pagë vjen në shtëpi. Sepse ju thashë në fillim të bisedës, ne ishim tetë e vetëm babai ka punuar. Kështu që, më kujtohet shumë mirë fillimi i punës në “Metaliku”. Por fatkeqësisht, shkurt ka qenë, menjëherë pas kësaj vjen ftesa për ushtri dhe duhet të nisesh.

**Anita Susuri:** Në cilin vit keni shkuar?

**Dragutin Ivanoviq:** Kam shkuar, si shumica e njerëzve më kujtohet normalisht edhe data, vetëm mos më pyetni për numrin e armës, ajo nuk më kujtohet. Kam shkuar më 01. 04. ‘70, në fakt ‘69, në vitin ‘69 për Sombor, tre muaj atje në një stërvitje, pas kësaj edhe 15 muaj në Mostar, në një qytezë të mrekullueshme të bukur i cili edhe sot më ka mbetur në mendje dhe të cilin e kujtoj me shumë kënaqësi dhe kështu me radhë. Pas ushtrisë...

**Anita Susuri:** Na tregoni pak për ushtrinë, për atë periudhën.

**Dragutin Ivanoviq:** Në ushtri, në Sombor në stërvitje që është natyrale dhe normale për atë kohë ka qenë shumë, shumë më vështirë. E kemi pasur të vështirë, ajo stërvitja, pak vështirë na ka rënë e sidomos mua sepse kam shkuar në ushtri më 18 vjet e gjysmë. Djalosh i ri, normalisht i kam mësuar të gjitha siç duhej, por me kalimin... pastaj ajo është thirrë risistemim, kam dashur risistemimin ta siguroj. Atëherë është ndërtuar aeroporti i Prishtinës apo i Shkupit, diku që të jem më afër shtëpisë sime, por fatkeqësisht risistemimi ka qenë në Mostar por nuk më ka ardhur keq. Atje më kujtohen ato ditët ushtarake, kanë qenë mjaft dinamike dhe kanë qenë disi të gjitha ditët të ngjashme sikur vezët, sikur veza me vezën. Të gjitha janë të përcaktuara, shumë prej tyre angazhime por edhe shumë momente të bukura.

Shikoni, kam pasur shumë miq, shumë përjetime, edhe të bukura edhe më pak të bukura, por ajo që më ka mbetur në mendje është shoqëria shumë e mirë. Jemi shoqëruar mirë, kemi qenë atëherë nga ish Juga [Jugosllavia] kam pasur aty shokë nga rrethina e Gjilanit, madje aty edhe nga, edhe më afër nga Gushterica, ka pasur nga Sllovenia, ka pasur nga Serbia, ka pasur nga Mali i Zi dhe kështu më radhë. E tani, aty është, që edhe lë një përshtypje të veçantë, aty keni mundur të shihni diversitetin e

njerëzve, kulturës dhe besimit. Dhe e gjithë kjo unë nuk jam shumë jugonostalgjik por jam njeri që i vlersoj vlerat pozitive, prandaj jam nostalgjik. Aty keni mundur të shihni, po them, gjithë atë diversitetin për të cilin po flas por megjithatë është disi i unifikuar dhe funksionon në mënyrë unike, dhe ka dallime.

Ka, mua më kujtohen shokët e mi deri, deri vonë i kam kontaktuar, njëfarë Nazmi nga rrethi i Gjilanit, njeriu, djali dobët e ka njohur atëherë gjuhën dhe pastaj kjo më kujtohet. Ai vinte te unë dhe, apo te njëri nga Kragujevci. Ne të tre kemi qenë gjithmonë në drekë, në mëngjes dhe tani Nazmi më thotë, “Tregoji kujdestarit që unë këtë e këtë nuk mund ta ha”, sidomos kur ka qenë ushqimi në pyetje, por të gjithë kemi pasur mirëkuptim, kështu që kurrë nuk ka pasur ndonjë vështirësi të veçantë.

**Anita Susuri:** E pastaj pas ushtrisë?

**Dragutin Ivanoviq:** Pas ushtrisë, çfarë të ju them kur e dini edhe vet. Pas ushtrisë, martesë, krijimi i familjes...

**Anita Susuri:** A ka qenë kështu kjo, pas ushtrisë të martoheni menjëherë?

**Dragutin Ivanoviq:** Po shikoni, ka qenë një, ka qenë një rregull i pashkruar që nëse njeriu nuk e përfundon ushtrinë, nuk është mjaft i aftë për familje. Ky ka qenë një rregull i pashkruar dhe ky rregull ka qenë i pranishëm tek të gjithë njerëzit në ish Jugën. Qoftë sloveni të shkoj deri në Maqedoni, nga Serbia lindore, deri në atë perëndimore dhe kështu me radhë. Kështu që ka qenë një rregull i pashkruar që megjithatë, të përfundohet ushtria, pastaj thoshim t’i shërbehet shtetit ajo që duhej të shërbehej, pastaj e ke njëfarë drejtimi në jetë, një obligim e ke hequr pastaj e ke pasur në rend martesën dhe kështu.

**Anita Susuri:** E si jeni njoftuar me gruan tuaj?

**Dragutin Ivanoviq:** Au, do të humbim shumë kohë.

**Anita Susuri:** (qesh)

**Dragutin Ivanoviq:** Do të përpiqem ta përmbledh në pak fjalë, me siguri ajo po i dëgjon të gjitha atje brenda. Është shumë interesante dhe kohërat kanë qenë të tilla. Vij nga ushtria, e shoh që një vajzë po banon tek ne. Sepse në fillim ju thashë që babai ka punuar vet, e ne shumë, edhe ajo hapsirë e vogël kur vinte ndonjë, ndonjë mësuese apo dikush në postë apo ndonjë kjo, kjo. Atëherë njerëzit nuk është normale as tani e lëre më atëherë të ketë hotele dhe kështu me radhë.

Dhe atëherë babai e ka pranuar këtë vajzën për banim. Kam ardhur unë nga ushtria, e ushtar ashtu, e shikova, më pëlqeu disi. Me siguri edhe unë asaj. Dhe kështu jemi, nuk kam pasur shumë problem të bredh të kërkoj vajzë kur tashmë është aty, kur tashmë ishte në shtëpi. Përndryshe, ajo është nga Shtërpca, aty ka ardhur si arsimtare e muzikës. E unë ju kam thënë, unë si djalosh e doja muzikën dhe

e gjithë kjo është bashkuar dhe kështu jemi njoftuar. Nuk është dashur shumë të bredh dhe jemi martuar dhe kështu... më vonë u martuam...

**Anita Susuri:** Si kanë qenë traditat sa i përket fejesës, martesës?

**Dragutin Ivanoviq:** Vetë zakonet, nuk mund të ju them për traditat në Janjevë. Ka pasur aty edhe mjaft ndikim feja, unë ju thashë edhe pak më herët se Janjeva nuk do të ishte kjo që është sot, po të mos ishte kisha. Traditat kanë qenë që djali dhe vajza së pari duhej të regjistroheshin në kishë, atje shpallet që Janko Jankoviq, Marko Markoviq do ta merr atë dhe atë. Atëherë, martesë në kishë ka qenë e domosdoshme, në Komunë kuptohet. Bëhej dasma, dasmat kanë qenë shumë interesante, interesante kanë qenë për shumë arsye. Para dasmës kanë qenë edhe disa zakone që, kjo zakonisht bëhej të enjten para dasmës.

Dasmat kanë qenë zakonisht të dielën, do të thotë të enjten djali vjen me dasmorët e vet dhe familjen dhe e sjell unazën, unazën e arit vajzës. Kjo kryhet të enjten dhe ky është një vërtetim që të dielën do të jetë dasma. Dasmat kanë qenë në përputhje me kohën dhe mundësitë në atë kohë. Nuk kanë qenë luksoze siç janë tash, por kanë qenë shumë simpatike, shumë ka qenë e pranishme veshja kombëtare, ajo është veshja e vjetër prizrenase. Edhe sot është e ruajtur në disa pjesë të Rahovecit, Prizrenit... Kështu që, ato veshjet kanë qenë shumë të pasura, rituale, të pasura me ngjyra, të pasura me kualitetin e materialit dhe kështu.

Dhe në ato dasma ti je i ftuar apo unë, kushdo, ne shkojmë për të shikuar. Ato më shumë janë mbajtur në shtëpitë e tyre, në vatrën e vet, në oborrin e vet, edhe pse gjithçka ka qenë ngushtë, ka qenë bukur dhe interesante për ne dhe pastaj, nëse është dasma të ndonjë mik, Gllasnviq apo Palliq, atëherë edhe e gjithë Janjeva shkon atje dhe e shikon atë dasmën. Kështu që, ato traditat kanë qenë shumë të pasura dhe shumë interesante. Por, fatkeqësisht kjo nuk ekziston më, jo e tëra është zhdukur, jeta dhe dinamika e jetesës e kanë bërë të veten, kështu që... me mungesën e njerëzve, ka edhe mungesë të dasmave dhe të gjithave dhe kështu.

**Anita Susuri:** Atë ditë do të thotë kur janë martuar çifti kanë shkuar deri te kisha me të gjithë... si ka qenë kjo?

**Dragutin Ivanoviq:** Shkohet, çifti i ri së pari shkohet për nusen, te shtëpia nuses, shkon muzika, të gjithë krushqit, familja, shumë... Merret nusja dhe para kësaj kurorëzimi është caktuar, kjo do të jetë nën ritin e Meshës së Shenjtë ose Liturgjisë, kështu është tek ortodoksit dhe pastaj, të gjithë shkojnë nëpër këto rrugët e baltosura e të ngushta në drejtim të kishës. Këmbanat e kullës shënojnë fillimin e meshës, gjatë meshës kryhet ceremonia e kurorëzimi. Muzika pret jashtë dhe e ndërpren këngën. Kur përfundon ajo ceremonia në kishë atëherë muzika fillon dhe fillon dasma, fillon kolona dhe atëherë nusja për herë të parë vjen në shtëpinë e saj të ardhshme. Atëherë për herë të parë vjen tek bashkëshorti i saj i ardhshëm. Do të thotë nga kisha përfundon mesha dhe pastaj nusja shkon atje ku duhet.

**Anita Susuri:** A keni shkuar ju deri në Shtërpçë për ta marr nusën?

**Dragutin Ivanoviq:** Po, po kam shkuar por fatkeqësisht largësia normalisht, jo fatkeqësisht, largësia pak e bën të veten e kemi qenë më pak. Por kam shkuar, më kujtohet, ka qenë dimër muaji shkurt e Brezovica të duket edhe më simpatike por edhe më e vështirë. Rrugët e këqija, kushtet e ngjashme dhe Janjeva e rrethina dhe vet vendi i ngjashëm, 90 përqind i ngjashëm me Janjevën. Kështu që, gjithë kjo më kujtohet shumë mirë dhe më ka mbetur, është simpatike për mua. Nuk ju kam thënë në fillim, unë jam kosmopolitan. Mua këto që po më pyesni, më vjen shumë mirë dhe me shumë kënaqësi flas për këtë. Kur ju mua më pyesni, “A ju kujtohet ajo shkuarja në Shtëpcë?” Si nuk më kujtohet?

Kështu që në mendjen time, në edukimin tim kryesori është njeriu. Kryesore nuk është as feja, as kombi, as ngjyra, për politikë nuk do të doja të flas. Do të thotë, në qendër, në shpirtin tim, në edukimin tim është njeriu. Kështu që, sa më shumë multikulturalitet, sa më shumë ato... më keni pyetur, ato zakonet pastaj më janë dukur interesante sepse ato zakonet ndryshojnë nga fshati në fshat, e sidomos prej dy, dy kombeve. Kështu që, kjo për mua ka qenë interesante, por kështu jam rritur në familje, kjo nuk më ka penguar fare dhe ja ne për një vit, dy do ta kemi përvjetorit e 50-të të martesës dhe kështu.

**Anita Susuri:** Pas martesës, si ka rrjedhur pastaj jeta?

**Dragutin Ivanoviq:** Pas martesës gjithë kjo ka rrjedhur disi, ka pasur edhe momente të bukura, edhe të vështira. Ju thash në fillim, kemi qenë shumë në shtëpi. Tash familja po rritet. Atëherë është dashur ta lëshojmë shtëpinë time familjare dhe të kërkojmë diku banim në Janjevë, ndonjë dhomë, për t’u bërë të pavarur në jetë. Por kjo ka shkuar mjaft vështirë sepse duhet të kthehem te një periudhë e mëhershme, ka pasur shumë njerëz. Katër-pesë mijë banorë, nuk mund ta gjeni një dhomë të paguani qira dhe kështu. Më kujtohet që ato ditët e para ka qenë shumë, dhe vitet e para kanë qenë shumë të vështira. Pastaj, ku ta di, jemi munduar me disa kredi të bëjmë diçka, të, të vijmë deri te shtëpia jonë, ka shkuar mjaft vështirë por pastaj kemi marr vendim dhe babai pak vend që ka pasur në oborrin e tij na ka dhënë dhe e kemi bërë shtëpinë tonë familjare, e cila në atë kohë na i përmbushte shumë mirë kërkesat dhe kështu. Dhe e kemi ndërtuar shtëpinë tonë.

**Anita Susuri:** A është ajo kjo shtëpia?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, nuk është kjo shtëpia. Është shtëpia lart te kisha. Unë në atë shtëpi i kam lëshuar disa familje që kanë qenë të varfëra, i kam lëshuar pa kurrfarë kompensimi dhe ata ma kanë shkatërruar atë dhe nuk do të doja të hyja në detaje lidhur me këtë. Kështu që, nuk është kjo shtëpi por ka qenë një tjetër...

**Anita Susuri:** Do të thotë, kjo është shtëpia ku familja juaj ka jetuar?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, jo kjo është shtëpia e tezës sime, apo si themi ne në Janjevë, tezës sime. Ne të nënës, motrën e nënës e kemi thirrur teza, e jo *tetka*.<sup>2</sup> *Tetka* ka qenë motra e babait, kështu që kjo shtëpia është e tezes dhe burrit të tezes. Ata në vitet e '90-ta, kur ka shpërthyer ajo luftë e mallkuar ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë, ata janë shpërngulur '92-tën. Dhe unë aty e mbaja një veturë dhe ka mbetur vendi i zbrazët, e këtu ka kushte më të mira të jetës, ka ujë. Lart ku, ku ka qenë shtëpia ime lart, nuk ka ujë të ujësjellësit e rrallë vjen njëherë në muaj. Ujë burimor nuk kemi pasur dhe pastaj kam ardhur këtu te teza për shkak të ujit dhe kështu. Dhe duke llogaritur se ka shumë mundësi se ata do të kthehen në shtëpinë e tyre dikur, që edhe unë të shkoj në timen por jeta, planet tona janë një, tjetër të Zotit. Nuk janë përputhur, kështu që kjo është ajo. Kjo është ajo. Kjo është shtëpia e tezes sime.

**Anita Susuri:** Kur flasim për ato lagjet po thoni lart, a ka qenë për shembull e ndarë kush ku jeton? Kush jeton në atë lagje kush në këtë...

**Dragutin Ivanoviq:** Jo. Nuk ka, ndarje të tilla nuk ka pasur. Ndarje ka pasur nëse familja e ka pasur ndonjë metër katror më shumë të hapsirës, aty është ndërtuar shtëpia, janë koncentruar familjet, familja. Ne saktë e dinim ku kanë qenë Geçeviqët, ku kanë qenë Ivanoviqët, ku kanë qenë Palliqët. Kështu që, nuk ka pasur shumë lëvizje, nëse dikur është dashur, atëherë ka ardhur edhe deri te ajo.

**Anita Susuri:** A dini diçka lidhur me ato shtëpitë afër kishës? Është një shtëpi ashtu më e vjetër, në kënd, atëherë edhe një me një kulm karakteristik...

**Dragutin Ivanoviq:** E di.

**Anita Susuri:** Kush ka jetuar aty? Kush...

**Dragutin Ivanoviq:** Aty kanë jetuar të gjithë, të gjithë ata janë që thuhet, aty kanë jetuar komshinjtë e mi, fqinjët dhe unë ata njerëzit shumë mirë i mbaj në mend dhe i kujtoj me kënaqësi. Ata njerëz i kanë lëshuar shtëpitë e tyre dhe kanë shkuar për Kroaci. Kjo ka ndodhur '91, '92, '93 dhe kjo tani ka mbetur e ekspozuar për shkatërrim, e ekspozuar për fatkeqësitë e kohës. Në fillim të kohës kemi thënë si dhe nga çka janë të ndërtuara ato shtëpitë dhe tani nëse në shtëpi nuk ka njerëz, nëse nuk ka njerëz të gjallë, ajo edhe ashtu rrënohet. Kështu që, ata njerëzit e kanë lëshuar dhe kanë shkuar.

**Anita Susuri:** Përse janë ato shtëpitë aq karakteristike, a kanë qenë ata financiarisht më mirë apo...

**Dragutin Ivanoviq:** Shikoni, pikërisht për këto shtëpi që po flisni, ata ishin njerëz me gjendje më të mirë financiare. Ata edhe sot janë në gjendje të mirë financiare, unë ato familjet, ato familjet i di. Në Zagreb shpesh shihemi, nëse jo me më të moshuarit, por me gjeneratën time dhe fëmijët e tyre, ata janë edhe tani të pasur, kështu që i njoh unë ata njerëz.

**Anita Susuri:** A keni qenë ndonjëherë brenda asaj shtëpie? A ju kujtohet?

---

<sup>2</sup> Në gjuhën serbo-kroate *tetka* ka kuptimin e hallës dhe tezës. Tek kroatët e Janjevës, *tetka* është halla, ndërsa *teza* është teza.

**Dragutin Ivanoviq:** Po, si jo. Sidomos njëra, aty është te kisha, në hyrje të kishës, tani kur niseni, ajo është në anën e majtë. Më kujtohet në atë shtëpi ka qenë stacioni i policisë, menjëherë pas luftës. Por nuk më kujtohet ajo, por më vonë më kujtohet, kur ata e fituan atë dhe kur policia e ka lëshuar dhe ia kanë kthyer atyre që ju përkiste shtëpia. Gjersa shkoja si fëmijë edhe si i rritur për Shën Kollin, apo kur ishte ndonjë festë fetare. Ndarjen e atyre dhomave e di shumë mirë, kështu që shumë me kënaqësi i kujtoj ato shtëpi. Por sinqerisht më duhet të ju them sa herë që shkoj, unë, e shihni që vështirë lëviz por mund të ngas veturë. Dhe ngas pa kurrfarë problemi dhe kur e shoh atë shtëpi, më besoni një nostalgji dhe emocion më zgjohet që, që më vjen shumë keq.

**Anita Susuri:** Do të thotë, kjo është ajo shtëpia në kënd, menjëherë kur fillon nga...

**Dragutin Ivanoviq:** Një rrugicë të dërgon {shpjegon me duar} nga ana e djathtë, njëra shkon në kishë...

**Anita Susuri:** Shtjefën Gjeçovi?

**Dragutin Ivanoviq:** Kah Shtjefën Gjeçovi, një rrugicë e vogël shkon për kishë, drejt, direkt. E, jo kah Shtjefën Gjeçovi por kur shkoni kah kisha, dyert janë të hapura, çdo gjë është e thyer, po ju them nganjëherë jam shumë i ndjeshëm sepse kam, sepse ata janë, më keni pyetur në një moment a kanë qenë njerëz të pasur...

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Do të thotë më keni folur për atë shtëpinë afër kishës...

**Dragutin Ivanoviq:** Ju kam folur, ju më keni pyetur a janë njerëz të pasur. Unë ju kam thënë po. Por ata kanë qenë shumë të pasur edhe në shpirt, dhe kanë qenë materialisht të pasur por edhe në shpirt kanë qenë të pasur. Kanë qenë shumë njerëz të mirë. Dhe e dini kur, kur njerëz aq të mirë shkojnë largohen nga jeta jote, që në gjuhën popullore themi “në shpejtësi”, përnjëherë. Atëherë kjo, kjo është e vështirë. Mua më kujtohen të gjitha ato largimet, dhe të ju them të drejtën, shpirti më dhemb që janë, që është dashur të bëhet ashtu.

**Anita Susuri:** Mirë, mendoj se, siç e di unë, shumica e njerëzve i kanë pasur punëtoritë në shtëpitë e tyre, a ju kujtohet kjo?

**Dragutin Ivanoviq:** Keni bërë pyetje shumë të mirë, mirë po ju kujtohet. Nuk e di, nuk e di kush ju ka dhënë të gjitha këto, këto të dhënat, e kjo në fund nuk është me rëndësi (qesh), pyetje shumë e mirë. Dhe prapë kjo është e lidhur me madhësinë e familjes, familjes, 80 përqind e bashkatdhetarëve të mi, banorëve të Janjevës kanë jetuar nga prodhimi i tyre. Ju po e shihni konfigurimi dhe pozita e Janjevës është e tillë që nga bujqësia konstante nuk mund të jetohej. Populli këtu më shumë ka jetuar që edhe

mirë pyetët, me prodhimin e tyre. Së pari Janjeva nëse kthehemi në një të kaluar të largët sepse ajo përmendet që nga 1303-ta, do të thotë që atëherë deri te vitet e '90-ta njerëzit janë marrë me zanate.

Njerëzit janë marrë me shkrirje të metalit e kur ndoshta nuk kanë mundur me shkrirje të metalit, nuk ka pasur për momentin treg, njerëzit më vonë kanë filluar të merren me përpunimin e plastikës, përpunimin e lëkurës. Kështu që, çdo shtëpi e ka pasur një shkritore të vogël në miniaturë, apo makinat për përpunimin e plastikës, përpunimin e lëkurës. Më kujtohet shumë mirë '86-tën apo '87-tën të themi, ato vite Janjeva i ka pasur 260 punëtori të regjistruara për prodhimin dhe përpunimin e plastikës. Këto janë të dhënat nga Kuvendi Komunal i Lipjanit nga zyrja që është marrë me këtë çështje. Kështu që, përveç fabrikës për të cilën folëm pak, për "Metalikun", njerëzit kanë jetuar nga puna e tyre. Njerëzit kanë jetuar... jo mjaftueshëm, më duhet ta pranoj, jo mjaftueshëm të shkolluar por mjaft mendjemprehtë, shumë të zgjuar, shumë mjeshtër të mirë dhe kanë jetuar kryesisht nga puna e tyre.

Më duhet t'iu përmend këtë, në fakt jo që duhet, por tani më kujtohet me krenari një tregim, biseda e kryetarit të Komunës së Lipjanit dhe njërit nga Lidhja Socialiste apo ku ta di unë. Ka pasur funksionerë të tillë, thotë dhe tani njëri-tjetrit i drejtohen, thotë, "Shiko bre, çdo të hënë në Lipjan më vijnë njerëz kërkojnë lëmshë, nuk kanë njerëzit mjaft", e thotë, "Njerëzit nga Janjeva, kroatët, kurrë askush te dera nuk më ka ardhur". Kjo tregon vetëm se njerëzit kanë jetuar kryesisht nga puna e tyre. Kështu që, këtë pyetje që ma keni bërë është shumë me vend dhe mund t'iu them që prodhimin e tillë e ka shfrytëzuar edhe Komuna e Lipjanit, normalisht me taksat që i ka vjelur dhe kështu me radhë, dhe të gjitha që pasuan.

**Anita Susuri:** Ata që janë...

**Dragutin Ivanović:** Më falni. Ato punëtoritë e shtëpive ka qenë kënaqësi t'i shikosh. Ka punuar fëmija me pesë-gjashtë vjet e deri te plaka me 80-90 vjet. Të gjithë kanë qenë të kyçur në prodhim. Për secilin ka pasur ndonjë punë. Kështu që, aty krahas përfitimit ekonomik dhe mënyrës për të mbijetuar, fëmijët e kanë fituar shprehinë e punës. Dhe mund të ju them që shumë, shumë prej tyre janë shumë të pasur dhe biznesmen të shkathët në Kroaci atje ku jetojnë. Sepse e kanë marr shprehinë e punës që nga fëmijëria, ju kam thënë, deri pesë-gjashtë vjet. Kështu që, Janjeva në ato vite për të cilat po flasim është sjell edhe prej, diçka që i ka munguar këtij rrethi të gjerë, mjedisit. Kanë rrjedhur këtu kultura të ndryshme.

Këta njerëzit kanë prodhuar por edhe vet i kanë shitur prodhimet e tyre. E janjevas ka pasur nga Ljubljana deri në Manastir apo nga Ankaraja deri në Ulqin. E tani, ata njerëz e kanë sjellë me vete kulturën e caktuar dhe zakonet e atyre vendeve. Kështu që, Janjeva është dalluar për shumë gjëra nga rrethina e gjerë këtu. Falë, po them, asaj lëvizjes, mobilitetit, zakoneve dhe kështu me radhë.

**Anita Susuri:** A keni punuar te "Metaliku", pas ushtrisë kur keni ardhur nga ushtria apo çfarë keni bërë më pas?



**Dragutin Ivanoviq:** Te “Metaliku” kam punuar pas ushtrisë dhe kam punuar te “Metaliku” deri në vitin ‘90-të. Kam punuar si komercialist dhe kam pasur rast të udhëtoj normalisht nëpër gjithë Jugosllavinë dhe t’i shesë prodhimet e fabrikës. Kështu që, te “Metaliku”, thashë kam punuar si komercialist në shitje deri në vitin ‘90-të. E kam pasur mirë, kam qenë i kënaqur me punën time, sidomos ka qenë dinamike për njeriun e ri, që ju, sa para do të duheshin, shpeshherë flas me fëmijët e mi dhe mbesat, sa para do të më duheshin tani t’i vizitoj të gjitha ato [vende]. Nuk ka, nuk ka qytet, fshat të vogël, fshat ku nuk kam qenë. Kështu që, jam shumë i kënaqur dhe “Metaliku” ka qenë ai që ma ka siguruar jetesën kur është dashur. Normalisht edhe gruaja ka punuar në arsim, në shkollë.

**Anita Susuri:** Këtu në Janjevë?

**Dragutin Ivanoviq:** Këtu në Janjevë, sepse ajo aty ka ardhur në vitin ‘68 dhe më nuk ka shkuar nga Janjeva. Do të thotë, këtu është plot 51 vjet këtu në Janjevë. Kështu që “Metaliku”, më keni pyetur, por unë duhet ta përmend njëjtë edhe shkollën, ajo na ka ndihmuar që më vonë t’i shkollojmë, i kemi pasur dy vajza, dhe kështu... Pastaj ku, pas “Metalikut”, kam punuar në një ndërmarrje shumë të fuqishme nga Zagrebi, ajo është “Kemikalija”, në fakt ajo ka qenë organizatë punuese, kështu është quajtur atëherë, e cila është marrur me shitjen e të gjitha prodhimeve kimikale nga Kroacia. Do të thotë, aty ka qenë i pranishëm Karbon, Kromos, të gjitha fabrikat më të fuqishme të kimikateve nga Kroacia. E kemi pasur përfaqësinë tonë në Prishtinë dhe kam menduar, kam menduar që do të jem njeri edhe më i lumtur, ka qenë fabrikë shumë e fuqishme por fatkeqësisht, çdo gjë që është e bukur, populli thotë, është edhe e shkurtër, çdo gjë që është e bukur zgjat pak. Ajo luftë e mallkuar atëherë e ka bërë të veten dhe ne është dashur të, të vjen deri te ndarja e martesës, te... kështu që më pas lufta e radhës ishte këtu në Kosovë... dhe çfarë të...

**Anita Susuri:** Vitet e ‘90-ta keni punuar te “Metaliku”? Pastaj në Prishtinë?

**Dragutin Ivanoviq:** Te “Metaliku”, nga e ‘90-ta deri në ‘99 në Prishtinë, në qendrën sportive “Boro Ramizi”, aty i kemi pasur zyret, në fakt aty kemi qenë qiramarrës, qiranë ia kemi paguar atyre. Nëse tani mjaft e njihni atë objekt, e unë e di në shpirt, kemi qenë poshtë në atë bodrumin, i kishim depot tona, e lartë ndërmjet dy sallave sportive i kemi pasur zyret dhe kështu.

**Anita Susuri:** Para viteve të ‘90-ta, do të thotë kur keni punuar te “Metaliku”, a ju, a ju kujtohet diçka interesante, që ju ka ndodhur për shembull? Apo si ju shkonte puna?

**Dragutin Ivanoviq:** Pyetje shumë interesante, por disi e dyfishtë, a mbani mend diçka. Mbaj mend, nuk e di në çfarë konteksti ju mendoni se a e mbaj në mend.

**Anita Susuri:** Për shembull, çfarë ju ka ndodhur juve apo...

**Dragutin Ivanoviq:** Mua te “Metaliku” deri, gati deri ‘90-tën sa kam punuar, me përjashtim të viteve të fundit që më lanë një përshtypje shumë të keqe për të cilën nuk do të dëshiroja të flas. Mua te “Metaliku” më kanë ndodhur shumë gjëra të bukura në jetë. Dhe unë jam, jam shumë i kënaqur me atë fabrikë, këtë ju thashë në fund pak më parë, përmes punës gjatë shërbimit tim, gjatë udhëtimeve etj.

Kështu që, për “Metalikun” më lidhin kujtime shumë të bukura, kujtime shumë të dashura. Dhe më duhet për “Metalikun” njejtë të, atë që e thashë për atë shtëpinë afër kishës, kur kaloj dhe më kaplon një kujtim dhe trishtim, e shpesh më kaplon kur kaloj për Graçanicë dhe Prishtinë. Kur pak kaloj me veturë, e kthej kokën, e shoh zyren time, zyren time, e atëherë fëmijët më pyesin, “Pse gjithmonë po kthehesh, ti vetëm ‘Metaliku’, ‘Metaliku?’” E ju them, “Shpirti im, po të mos ishte ‘Metaliku’, as ti nuk do të arsimoheshe”. Dhe kështu... kështu që ka shumë kujtime të bukura, por, por fatkeqësisht kjo u ndërpre.

**Anita Susuri:** Ku keni udhëtuar gjatë kohës kur keni punuar te “Metaliku”?

**Dragutin Ivanoviq:** Sa kam punuar, kam udhëtuar nga Kranji dhe Koçevje deri në Manastir. Nga Novi Sadi deri në Zllatibor dhe... kështu që kam udhëtuar, kam punuar nëpër gjithë Jugosllavinë. Por pesë-gjashtë vitet e fundit kam punuar veçanërisht dhe kam kryer shitjen e prodhimeve të “Metalikut” veçanërisht në Serbi. Kështu që, kjo është afërsisht ajo që mund t’ju them. Do të thotë ish Jugon, sot ndoshta do të më duheshin shumë e shumë euro që të mund t’i kaloja të gjitha këto. Më pyetët nga, paj prej Ljubljanes deri në Manastir dhe kështu.

**Anita Susuri:** Ju më keni thënë që i keni dy vajza. A janë ato të shkolluara këtu në Janjevë apo?

**Dragutin Ivanoviq:** Këtu janë, njëra është e shkolluar, kombinim Prishtinë dhe Gushtericë, e ka përfunduar shkollën e mesme të mjeksisë dhe sot punon aty, përndryshe ka punuar, e ka përfunduar të mesmen e mjeksisë ju thashë, drejtim i përgjithshëm. E ka punuar diku dy vite në Prishtinë në spital dhe kemi udhëtuar bashkë. Unë deri te “Boro Ramizi”, atë e lë te spitali. Më vonë është martuar me një djalë nga Prishtina e jeta ka dashur të bëhet ndryshe, ata janë shpërngulur këtu në Janjevë, ajo është tani aty në shtëpi të shëndetit dhe kështu. Kjo vajza tjetër fatkeqësisht... nuk ka arritur të shkollohet, jo që nuk kemi mundur unë dhe gruaja, por, por, por... por ka diçka në shpirt që më djeg dhe më dhemb. Ajo lufta e ka bërë të veten në Kroaci dhe, dhe në ish Jugon dhe pastaj gjithë ai shoqërimi nuk ka pasur mjaft liri dhe ajo vajza e dytë ka mbetur vetëm me shkollë fillore që ta them të drejtën, si prind më dhemb. Sepse dhemb kur nuk keni mundësi të shkolloheni, i dhemb secilit prind. Por njejtë dhemb edhe kur keni mundësi e dikush ua ndalon. Kështu që, ja kjo është me dy vajzat.

**Anita Susuri:** Desha të ju pyes më shumë për Janjevën, tani për çarshinë. Si ka qenë atëherë çarshia, para të ‘90-tave?

**Dragutin Ivanoviq:** E çarshia ka qenë, ka qenë parajsë në tokë, sepse çdo gjë që ka ndodhur në këtë gropë që unë shpesh di ta quaj, në këtë kuadraturë [të vogël]. Çdo gjë që është bërë dhe që ka ndodhur edhe gëzimi edhe pikëllimi edhe puna edhe humbja e punës edhe, edhe momente të bukura edhe grindja, e gjithë kjo ka ndodhur në çarshi. Çarshia ka qenë shumë simpatike. Çarshia ka qenë vend ku ke kaluar shumë kohë. Njerëzit, po them relativisht, kanë pasur mjaft para. Vjen ai nga Kikinda, vjen ky nga Titov Veles, vjen dikush nga Sarajeva, vjen... ne të gjithë takohemi aty te çarshia dhe... shpirti më dhemb.

Unë shpesh shkoj te ajo Bash Çarshia. Ajo ka qenë të them ashtu kafeneja ime. Por kemi qenë 10 - 15 shokë, që çdo ditë kemi qenë... Më shumë kam qenë me ata njerëz se sa me gruan time. Çarshia me shumë shaka, anekdota të fshatit, gjithnjë çarshia e ka pasur një *ller*<sup>3</sup> të vetin, e dini ju çfarë është *llero*? Secili qytet në viset tona e ka një *ller*, e ka pasur edhe Janjeva *llerin* e vet. Aty kanë ndodhur edhe shakatë në mënyra të ndryshme. Kështu që, nuk është, nuk është e ndërtuar si tani. Këto kanë qenë ato kafenetë, tani janë pak të rregulluara, pak më mirë të ndërtuara, e gjithë kjo ka qenë në një nivel të thjeshtë, modest, por shumë shumë e rëndësishme me shumë shpirt, me shumë kuptim për jetën, shumë kuptim për punën.

Çdo gjë është që ka ndodhur, ka ndodhur në çarshi. Ajo ka qenë edhe e baltosur edhe tavernë e zezë, por ka qenë edhe ajo që do të të ndihmoj. Mua më kujtohet, vetëm në moment do të mundohem shkurt t'ua përshkruaj. Kur e kam bërë shtëpinë, mungesa e mjeteve, mungesa e parave, çfarë të bëj, flas me gruan, nesër do të, është vrenjtur, duhet ta vendosim kulmin, nuk kemi mjaft para. Ajo çarshia ka qenë ajo që nuk të lë pa kulm mbi kokë. Atëherë i them gruas, "Hajt shko ti te ato miket që i ke, unë te shokët e mi, të dalim në çarshi". Dhe tani, më duhet, hajt të themi si tani diku një mijë euro, dy mijë, si t'i kërkoj, më vjen turp prej njerëzve.

I pi nja dy rakia të më hiqet ai turpi (buzëqesh), por ata njerëzit jepin. Dhe thonë, "Pse po ngurron?" Kjo vetëm, e kam marr një shembull, çdo gjë ndodhte në atë çarshi. E nëse do të ktheheshim tani prapa, mua shpirti më dhemb kur unë ulem në atë Bash Çarshi e më besoni nuk keni me kë ta pini një kafe...

**Anita Susuri:** A ju kujtohet aty ku është Bash Çarshia, aty është një objekt i vjetër? Çka ka pasur aty?

**Dragutin Ivanoviq:** Përball Bash Çarshisë ka qenë një mishtore. Dhe aty ka qenë edhe kënaqësia e asaj çarshisë, që në një vend aq të vogël e keni pasur edhe mishtoren, katër-pesë, jo një. Keni pasur edhe shitore, edhe punëtori, keni pasur çdo gjë që i është nevojitur një familje, familjes. Ajo e vjetra aty, ajo ka qenë mishtore...

**Anita Susuri:** Nga 1928 më duket se shkruan aty.

**Dragutin Ivanoviq:** Shkruan ajo është...

**Anita Susuri:** Ka qenë ndoshta edhe kafeneja në atë objekt.

**Dragutin Ivanoviq:** Atëherë nuk jemi [kuptuar], aty është kafeneja, nën kafene është mishtorja për të cilën fola më herët. Ka qenë kafeneja të cilën e ka mbajtur pronari i asaj shtëpisë. Ajo ka ndërruar pronësi, dikur ka qenë edhe e shtetit, në pronësi të shtetit dhe kështu, por është, por ka pasur gjallëri, po them, ka qenë... sepse sipas aspektit sociologjik, sipas aspektit të sociologjisë, kur e shikoni Janjevën është shumë interesante edhe për atë shkencë, sepse pesë mijë njerëz kanë arritur të mbijetojnë dhe të jetojnë bukur në këtë hapsirë kaq të vogël.

---

<sup>3</sup> Komedian lokal.

Unë shpesh i kam folur profesorit të sociologjisë i cili ka dashur të vij disa herë në Janjevë, “E si Drago?” Thotë ai, dhe vijnë. Zakonisht të dielën aty në çarshi dhe tani po dalin gratë, vajzat dhe njerëzit nga kisha, aty aq bukur janë veshur, aty ka qenë moda ajo çka keni pasur ndoshta ndonjëherë në Knez Mihajlova, në Janjevë ka mbërritur fillimisht dhe tani ai thotë, “Si?” Tregon me gisht kah njeriu, “Sa fëmijë i ka ai”? I them, “Dymbëdhjetë”. E ai e shikon si duket me atë kapelë, “Por, por, por ai njeriu, ai njeriu ka shumë para,” “Paj nuk e di unë,” i them, “nuk jam unë në xhepin e tij”. Kështu që, po them nga ai aspekt i sociologjik ka qenë shumë shumë interesante sepse rrethi më i gjerë nuk, nuk ka qenë në atë pozicion.

Shumë ka dalluar prej këtyre fshatrave, prej Graçanicës, e ku ta di unë, Dobrotinit, të gjitha ato fshatrat, Janjeva e ka pasur kulturën e veçantë e këtë më duhet t’ua përmend, por atë e kam thënë edhe gjatë bisedës, ndikimi i kishës ka qenë në nivel shumë të lartë në kuptimin pozitiv. Dhe ai multikulturaliteti, që unë po të them ty [i drejtohet intervistuesës] vinte nga të gjitha anët e Jugosllavisë, ka bërë që Janjeva me të vërtetë ta ketë një jetë romantike dhe tani kur i kthehem dhe më kujtohet, e gjithë kjo ka ndodhur në këtë gropë, njerëzit e mi. A është e mundur? Kështu që, ka qenë një jetë shumë romantike. Njerëzit shpirtërisht dhe materialisht mjaft të pasur, edhe natyra e pasur, e natyra ka qenë, ju aty keni pasur vreshta, po nuk ka pasur metër katror të vendit të papërpunuar. Ka qenë si, ne i thoshim Misir, është një pjesë në, afër Nilit atje në Egjipt, ajo ka qenë, çdo gjë ka qenë e përpunuar, çdo gjë. Edhe njerëzit edhe natyra e kanë pasur njëfarë përshtatje, njëfarë bashkësie është ndjerë.

**Anita Susuri:** Sa i përket çarshisë, desha t’ju pyes edhe për një shtëpi, objekti që gjendet aty. Shtëpi mjaft e madhe, me tri hyrje.

**Dragutin Ivanoviq:** Me tri hyrje, po. Ajo shtëpi është ndërtuar kohë më parë, ajo mund ta vëreni, ajo sipas stilit pak dallon prej të tjerave. Më shumë është stili amerikan i ndërtimit sepse dy vëllezër apo tre kanë qenë duke punuar në Amerikë. Ajt diku në 1920-tën, ‘30-tën dhe kështu me radhë, do të thotë para Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj ata, prandaj ajo i ka dy-tri hyrje. Ata dy-tre vëllezërit e kanë ndërtuar dhe ajo ka mbetur aty edhe sot. Shpeshherë familjarët normalisht janë munduar ta mirëmbajnë sado që është e mundur, në gjendje sa më të mirë. Prandaj kjo shtëpi për këtë edhe dallohet.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Ju kam pyetur për atë objektin në çarshi.

**Dragutin Ivanoviq:** Kjo është ajo që ju kam thënë, është ai objekt.

**Anita Susuri:** Aty vetëm, aty vetëm kanë jetuar ata apo ka qenë, kanë punuar diçka?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, vetëm ata kanë jetuar aty, nuk kanë punuar asgjë, aty dikur ka pasur dyqane, disa shitore të ndërmarrjeve shtetërore. Kështu që, ata tani, aty është një e grua e moshuar me bijat,

ata tani jetojnë prej atyre dyqaneve. Përndryshe më herët nuk ka, nuk ka qenë kjo për ata burim i të ardhurave. Ja që njerëzit kanë menduar, sipas meje pozitivisht, herdo kurdo ato do të jenë të dobishëm, kështu që sot, kur shumë prej tyre nuk janë më, vetëm është ajo moshuara me të bijat, ato dyqane asaj mirë i vojnë. Aty punojnë disa djem etj. kujt çka i nevojitet, dhe ja prej asaj mbijeton. Përndryshe shumicën e kohës, ata prej asaj nuk kanë jetuar, ndoshta ajo ka qenë për ata, jo ndoshta por tejet e parëndësishme.

**Anita Susuri:** Si ka qenë mbiemri?

**Dragutin Ivanoviq:** Palliq.

**Anita Susuri:** Palliq, ata kanë jetuar aty. A kanë jetuar ata gjithmonë aty?

**Dragutin Ivanoviq:** Gjithmonë, gjithmonë...

**Anita Susuri:** Çfarë tradita të tjera keni pasur? Për shembull, çka keni festuar, ato festat tuaja, si i keni kremtuar ato?

**Dragutin Ivanoviq:** Shiko, tek ne katolikët sipas fesë ka shumë festa dhe unë ndonjëherë duke bërë shaka me shokët e mi të them se si kalendari ynë është shumë i pasur me ditë pushimi (qesh). E shikoni, ka qenë shumë, shumë interesante. Keni përmendur diçka që është shumë edhe e rëndësishme. Familjet e mëdha, festa të shumta, sidomos fetare, unë për ato po flas. Atëherë është ditur që unë të shkoj me gruan, babai im, nëna dhe të shkojmë tek fqinjët, Nikolla, e sot është Shën Nikolla, ai e feston dhe ne të gjithë familjarët shkojmë tek ai. Dhe të tillë, sidomos kur është Shën Nikolla, ju keni mundur ta shihni lëvizjen dhe një frekuencë të jashtëzakonshme nëpër Janjevë. Tani shkoj tek daja, Shën Nikolla edhe shokun Nikolla e kisha, edhe tezja e kishte djalin Nikolla, e aty, aty vetëm lëviznim dhe ajo është shumë e dukshme në këtë hapsirë të vogël.

E dini, sikur të ishte në ndonjë, në ndonjë qytet më të madh apo në ndonjë vend në Vojvodinë, ku fshatrat janë të shpërndara, nuk do të ishte aq... por është aq e dallueshme dhe dukej shumë interesante. Ishte, ishte për të ardhur keq apo turp të mos shkoja te xhaxhai t'ia uroj ditën e emrit, ai të mos vij tek unë dhe kështu. Dhe ishte kryesisht gjatë atyre festave që shkonim, diçka që është shumë e rëndësishme dhe që dua ta theksoj, me një garderobë të veçantë, ndonjëherë me veshje popullore. Në pjesën më të madhe, gratë veshnin veshje popullore, përndryshe meshkujt kanë qenë gjithmonë evropian, me veshje evropiane. Por aty është gjithmonë një kravatë e pastërt, kostumi dhe kështu, do të thotë për ato ditë nuk është shkuar si unë që po rri kështu lirshëm dhe kështu.

**Anita Susuri:** E gratë kanë qenë me dimija apo?

**Dragutin Ivanoviq:** Gratë më shumë kanë qenë me dimija, me shallvare, sido që dëshironi, me dimija me ngjyra shumë kolorite dhe veshje tradicionale. Dhe pastaj në ato festa, llafosnim, bisedonim, flisnim, këndonim... dhe kështu. Dhe kanë ditur të qëndrojnë deri në orët e hershme të mëngjesit sepse keni shumë Franjo apo Nikolla apo Stjepana apo ku ta di unë. Kjo është ajo.

**Anita Susuri:** A ka pasur ndonjë përgaditje speciale sa i përket ushqimit?

**Dragutin Ivanoviq:** Po, po, sidomos ushqimi. Normalisht, me mundësitë e familjes por që thotë populli për ato ditë, është dashur të kesh. Shumica e ballkanasve, gjindemi në ato ditë, duhet, duhet. Kështu që, është shënuar në mënyrë të veçantë edhe përmes ushqimit, edhe përmes vizitës dhe përmes veshjes. Në bazë të shumë gjërave është ditur që është një festë në Janjevë. Unë deri sa punoja vinin shumë miq, vijnë edhe sot. Vijnë aty edhe shqiptarët, edhe serbët edhe turqit dhe mua më vjen shumë mirë dhe kjo ndoshta edhe më mbanë ende këtu, këtu ku jam. Pak e kaloj, po ju them, vinin miq për ato ditë kur janë festa të tilla që ne themi festa, festat kishtare dhe thotë, “Drago, unë nuk kam parë kësi njerëz,” thotë, “inteligjent, të pastër dhe veshje të tillë”, më duhet ta përmend, “Këtë në vende shumë më urbane,” thotë, “unë nuk kam parë”. Kështu që, kur bëhet fjalë për festa kjo është ndier.

**Anita Susuri:** Si kanë qenë për juve vitet e ‘90-ta? Si ka qenë këtu në Janjevë?

**Dragutin Ivanoviq:** Vitet e ‘90-ta kanë qenë shumë të vështira dhe do të doja që asnjë gjeneratë të mos i përjetoj, të mos ketë vite të tilla. Kanë qenë po them... shumë jam i ndjeshëm dhe mos ma merrni për të madhe nëse më dalin edhe lotët. Kanë qenë vite shumë të vështira, shumë të vështira. Kur ju largohen fqinjët, komshinjtë, sido që dëshironi me të cilët e keni kaluar fëmijërinë, jeni rritur, ju kanë ndihmuar në jetë, ju i keni ndihmuar ata dhe ju e shihni që përnjëherë nuk janë. Sot e kam përcjellur një fqinj, nuk kanë kaluar pesë-gjashtë ditë tashmë kamionët, shleperat po arrijnë po e përcjellin tjetrin. Ato momente janë shumë... emocionalisht më prekin dhe janë shumë të rënda sepse njeriu me qenien e vet disa gjëra nuk mund t’i tejkaloj edhe nëse do. Ajo është, nuk mund ta përshkruaj sa është e vështirë.

Kemi biseduar se sa kujtime të bukura ka në Janjevë, unë ju kam thënë dje, ne kur, unë do të mund t’ju flisja juve edhe tri orë për gjëra të caktuara. E më së paku kam dëshirë të, më shumë kam dëshirë të flas për gjëra pozitive, më shumë e dua pozitivitetin në jetë se sa negativitetin. Kështu që, ju po më pyesni për këto vite, mos dhashtë Zoti që të përsëriten. Dhe unë sinqerisht mund t’ju them, Janjeva, njëri prej shokëve të mi të mirë në shumë ndoshta edhe sot në funksion shumë të lartë diku, thotë, “Drago, ju jeni më së paku fajtor për të gjitha këto që kanë ndodhur, ju e keni përjetuar fundin më të hidhur”. Kështu që, këto janë ato vitet e ‘90-ta kur, kur për tri-katër ditë ju duhet t’i përcillni tri-katër familje. Shumë, shumë e vështirë...

**Anita Susuri:** Çfarë ka ndryshuar tani në Janjevë, pas atyre viteve të rënda?

**Dragutin Ivanoviq:** Pas atyre viteve të rënda vjen deri te, që është normale edhe me shkencë është e vërtetuar, pas atyre luftërave normalisht vjen edhe deri te një, një stabilitet. Atëherë vjen pak më shumë punë, vjen pak, lëviz pak jeta. Taman puna, po të mbetesha unë në vitet e ‘90-ta, nuk e di si do të bëhej, jo vetëm me mua, çfarë do të bëhej me njerëz. Atëherë vjen një periudhë më e lehtë, atëherë vjen një dhe disi, pajtoheni me fatin që është dashur të jetë ashtu. Dhe pastaj të vjen më lehtë por nuk e di, neve ballkanasve na ndjek edhe një fat i rëndë, do të doja që ju të rinjtë kurrë të mos i përjetoni

këto. Pas të '90-tave vijnë të 2000-tat, vjen prapë diçka që nuk është e këndshme për njerëzit, vjen ajo që ka ardhur në Kosovë, sepse...

Kështu që, këto dy raste nuk janë raste, ato janë, tamam puna të jenë raste, lehtë do të zgjidheshin, por ato janë situata të rënda. Pastaj vjen ai bombardimi, ato trazirat në Kosovë. Tani fqinjët e tjerë po shpërngulen, kalojnë aty, mua më kujtohet ja po them, jam shumë i ndjeshëm e them, "Omer" sidoqoftë, "Ndal, kemi punuar bashkë te 'Boro Ramizi'" ai prej këtyre fshatrave ikte dhe duhej të shkonte diku në mal e unë do doja ta mbaja aty pak të flasim, t'i ndihmoj disi. Thotë, "Drago, nëse ke ndonjë legen apo kovë plastike" thotë, "Ma jep," thotë, "kjo do të na nevojitet". Thotë, "Unë me gjithë qejf do të rrija edhe pak të flas me ty por ja të gjithë jemi nisur, po e lëshojmë fshatin dhe..."

**Anita Susuri:** Kjo ka qenë '99-tën?

**Dragutin Ivanoviq:** '99-tën, po, ndoshta jam edhe pak i i paqartë, pak edhe me emocione po i flas të gjitha këto, kështu që ato vite do të doja t'i, t'i vendos në harresë. Do të doja të mos ndodh kurrë, që një popullit kjo të mos i ndodh, të mos ju ndodh sidomos juve të rinjëve sepse... sepse shikoni, jeta, jeta mesatare e njeriut 'ajt tani është zgatur pak, 70-80 vite. Edhe pse ato, ato vite, një breshkë apo një shqiponjë jeton 150-200 vjet, edhe pse, edhe pse ato vite kalojnë ku është qëllimi i jetës atëherë? Ku është qëllimi, që, që, që në grindje... prandaj mua ndonjëherë edhe, jo ndonjëherë, gjithmonë më pëlqen te shqiptarët, thotë, "Çfarë është fqinji, dëshiron ta blej shtëpinë, dëshiron atë këtë, së pari ta shohësh çfarë është fqinji". Do të thotë, jeta aq e shkurtër të na kaloj pak me, me disa dukuri negative, tipare, të jetuarit, kurrë nuk do të doja që kjo të ndodhte.

**Anita Susuri:** E si ka qenë pas luftës?

**Dragutin Ivanoviq:** E pas luftës, shikoni, shumë...

**Anita Susuri:** Dita e çlirimit a ju kujtohet ajo?

**Dragutin Ivanoviq:** Pas luftës, mungesa e punës, që është edhe, që është problem edhe më i gjerë sot edhe jashtë bashkësisë dhe gjithë shtetit tonë të Kosovës. Pas luftës, konkretisht vjen prapë një situatë e keqe në Janjevë. Sidomos për neve kroatët, fëmijët nuk e fillojnë shkollën. Shekulli XXI që fëmijët të mos shkojnë në shkollë fillore, kjo është, kjo është përulëse për njerëzimin. Dhe normalisht ne përpiqemi sidomos falë kishës, priftit, ne përpiqemi të organizohemi që të bëjmë presion mbi Komunën dhe të gjithë njerëzit përgjegjës që fëmijët të fillojnë, që edhe fëmijët ta fillojnë shkollën. Sepse të gjithë fëmijët e filluan shkollën përveç, përveç fëmijëve në Janjevë në gjuhën kroate.

Kështu që, më ka mbetur në kujtim, të mos e përdor aq fjalën e rëndë, ajo beteja që gjithë kjo të filloj, që, që, që, që kjo të ecë, të vij në një përshtatje dhe barazi me këta banorët e tjerë në Kosovë të cilët i kemi në rrethinë. Do të thotë, të filloj edhe mësimi... e pastaj aty edhe mundohemi dhe ka shumë probleme, mungesë e kuadros... kuadri i cili ka qenë para luftës më shumë ka qenë nga ky rreth i gjerë dhe më shumë kanë qenë njerëzit e kombit serb të cilët fatkeqësisht në atë kohë nuk, nuk kanë

guxuar, nuk kanë mundur të vijnë dhe do të thotë mungesa e kuadrit dhe aty pastaj është shfaqur problemi.

Dhe pastaj kemi, që thuhet me nxitim, po të them [i drejtohet intervistueses], falë priftit, falë kishës dhe falë bashkësisë së gjerë të Kosovës kemi ardhur te ajo situatë që e kemi tonën, kështu që kur më pyesni, çfarë është? Atëherë është dashur të punoj në shkollë. Më keni pyetur prej ushtrisë, ku, sa, te “Metaliku” e sa te ajo “Kemikalija”, dhe pastaj vitet e fundit të përvojës së punës dhe vitet e fundit të punës atëherë me forcën e rrethanave në arsim dhe kështu. Kështu që na kanë...

**Anita Susuri:** Çka keni punuar në arsim, si mësues apo?

**Dragutin Ivanoviq:** Jo, në arsim kam punuar si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë serbo-kroate. Dhe pastaj aty shumë, shumë më ka ndihmuar bashkëshortja sepse ajo ka pasur përvojë në arsim, e unë kam qenë ekonomist, unë lidhje nuk kam me arsim. Por ato janë të gjitha pasoja të luftës, kur ju duhet të punoni diçka që kurr nuk keni punuar dhe vijnë njerëzit nga Zagrebi, atëherë ata pak më mirë i furnizojnë dyqanet e veta, lokalet dhe kështu. Kështu që gjallërohet, gjallërohet pak kur vijnë ata njerëzit.

**Anita Susuri:** A vijnë për një ditë, dy apo qëndrojnë më shumë?

**Dragutin Ivanoviq:** E po, shikoni si, vijnë ata për tri-katër ditë varësisht nga mënyra e festimit, mënyrës së festës, por në mesatare nuk do të doja të detajoja prandaj, mesatarisht tri-katër ditë qëndrojnë. Dhe ato tri-katër ditë me të vërtetë është bukur të qëndrosh në Janjevë, kënaqësi është, bisedojmë, i sheh familjarët dhe kështu.

**Anita Susuri:** A dëshironi të na thoni edhe diçka për fund, nëse diçka keni harruar?

**Dragutin Ivanoviq:** Po për shumë gjëra kemi biseduar. Frikësohem mos po përsëritet [këmbanat e kishës në sfond], e njejtat bisedë. Për fund, që të rinjtë ta kuptojnë që nuk është mirë ajo që na ka ndodhur neve, që nuk janë, që luftërat nuk janë të mira, që njerëzit e rinj e këtë edhe po e bëjnë ata, unë po e vërej të paktën në rrethin ku jam, të rinjtë ngadalë po lirohen prej disa paragjykimeve. Po për fund, që të ketë pak më shumë punë, po për Zotin edhe pak më shumë kulturë, një trajtim pak më të mirë për njëri-tjetrin, dhe do të jetë më e lehtë për të gjithë ne edhe që, që të mos harrojmë atë që ka ndodhur por vetëm të shikojnë të rinjtë përpara.

Nuk do të doja të, sepse me kthimin mbrapa nuk mund të arrini kurrë aty ku doni, ku e keni cakun. Kështu që, do të doja një përmirësim të jetesës për të rinjtë, jo vetëm në Janjevë por në gjithë Kosovën tonë. Sepse njëri prej shokëve të mirë, ashtu më shumë me ironi thotë, “Do ta shohësh do të bëhet Kosova si Zvicra”. E kjo ka qenë diku para shtatë-tetë vitesh dhe unë pas shtatë-tetë vitesh po e pyes, “Çka tash?” “E po unë kam menduar ashtu”. Kështu që, i kemi të gjitha parakushtet, ato vetëm duhet të shfrytëzohen. Dua që të rinjtë të jetojnë më lehtë.

**Anita Susuri:** Ju faleminderit.



**Dragutin Ivanović:** Ju faleminderit edhe juve.